

RREGULLORE E PUNËS
e Komitetit Monitorues të Instrumentit për Reforma dhe Rritje ndërmjet
Bashkimit Evropian dhe Kosovës

Komiteti Monitorues në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor (në tekstin e mëtejshëm, “Komiteti Monitorues i Instrumentit për Reforma”) është organ i themeluar në përputhje me nenin 25 të Marrëveshjes për Instrumentin të lidhur ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës për aranzhimet specifike për zbatimin e ndihmës financiare të Unionit për Kosovën në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor.

Neni 1
Fushëveprimi dhe detyrat

- (1) Komiteti Monitorues i Instrumentit për Reforma vlerëson shkallën dhe cilësinë e zbatimit të të gjitha reformave dhe investimeve drejt përmbushjes së objektivave të përcaktuara në Agjendën e Reformave dhe në Rregulloren (BE) 2024/1449. Për këtë qëllim, Përfituesi vendos monitorim të rregullt dhe sistematik, si në nivel politik ashtu edhe në atë teknik, si dhe aranzhime të raportimit për të informuar mbi progresin drejt arritjes së rezultateve të planifikuara, duke siguruar kështu që raportimi të Komisioni Evropian (në tekstin e mëtejshëm, Komisioni) të jetë i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.
- (2) Komiteti Monitorues i Instrumentit për Reforma diskuton progresin në zbatimin e reformave dhe investimeve, sistemet e menaxhimit dhe kontrollit, si dhe aranzhimet e zbatimit, promovimit dhe komunikimit.
Komiteti Monitorues i Instrumentit për Reforma mund t’i paraqesë propozime Komisionit dhe Koordinatorit Kombëtar të Instrumentit për Reforma dhe Rritje (në tekstin e mëtejshëm, Koordinatorit Kombëtar të Instrumentit për Reforma) për të rritur efektivitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të reformave dhe investimeve, si dhe për të siguruar koherencë dhe koordinim më të mirë me asistencën në kuadër të IPA III dhe asistencën financiare të donatorëve të tjerë. Për këtë qëllim, ai, sipas nevojës, merr parasysh konkluzionet dhe rekomandimet e nxjerra nga monitorimi dhe vlerësimet e ndërmarra nga Komisioni ose nga Përfituesi i Instrumentit për Reforma.
- (3) Komiteti Monitorues i Instrumentit për Reforma:
 - (a) Për fushën përkatëse të politikave, shqyrton progresin drejt arritjes së objektivave, dhe reformave e hapave të planifikuar, si dhe vlerëson ndikimin dhe qëndrueshmërinë e reformave në kuadër të Agjendës së Reformave, duke siguruar njëkohësisht koherencë me dialogun e politikave, strategjitë përkatëse sektoriale qendrore dhe rajonale, Shtyllën 1 dhe 2 të Planit të Rritjes, si dhe zbatimin e IPA III;
 - (b) Shqyrton raportet vjetore;
 - (c) Diskuton investimet, sipas nevojës;

- (d) Shqyrton gjetjet, konkluzionet dhe propozimet përkatëse për masa korrigjuese përcjellëse që dalin nga monitorimi, vlerësimet dhe auditimet dhe, sipas nevojës, shqyrton planin e veprimit të hartuar pas analizimit të sistemeve;
- (e) Diskuton çfarëdo aspektesh relevante të funksionimit të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit;
- (f) Vlerëson rreziqet për arritjen e objektivave, hapave të reformave dhe investimeve, dhe diskuton çfarëdo çështje dhe veprime problematike;
- (g) Sipas nevojës, propozon veprime korrigjuese për të siguruar arritjen e objektivave dhe për të rritur efektivitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e reformave dhe investimeve në kuadër të Agjendës së Reformave;
- (h) Shqyrton masat e ndërmarra për informim, publicitet, transparencë, komunikim dhe promovim, në përputhje me nenin 21 dhe 23, dhe propozon masa për përmirësimin e vetëdijesimit të qytetarëve për Instrumentin për Reforma.

Neni 2

Përbërja dhe kryesimi

- (1) Komiteti Monitorues i Instrumentit për Reforma bashkë-kryesohet nga Koordinatori Kombëtar i Instrumentit për Reforma), ose nga një person i autorizuar nga Koordinatori Kombëtar i Instrumentit për Reforma, dhe nga një përfaqësues i Komisionit.
- (2) Komiteti Monitorues i Instrumentit për Reforma përbëhet nga anëtarët dhe pjesëmarrësit. Lista e anëtarëve të Komitetit Monitorues të Instrumentit për Reforma përbën pjesë integrale të kësaj Rregulloreje të Punës dhe është në Shtojcën 1. Lista e pjesëmarrësve të Komitetit Monitorues të Instrumentit për Reforma përbën pjesë integrale të kësaj Rregulloreje të Punës dhe është në Shtojcën 2.

Neni 3

Sekretariati i Komitetit Monitorues të Instrumentit për Reforma

- (1) Komiteti Monitorues i Instrumentit për Reforma ndihmohet nga një “Sekretariat” i përhershëm. Sekretariati organizohet nga Koordinatori Kombëtar i Instrumentit për Reforma, me mbështetje nga Zyra e BE-së në Kosovë.
- (2) Sekretariati kryen të gjitha detyrat e nevojshme për zhvillimin e duhur të punës së Komitetit Monitorues të Instrumentit për Reforma dhe në veçanti:
 - a) Mbledh dhe/ose përpunon dhe ua shpërndan të gjithë anëtarëve të Komitetit Monitorues të Instrumentit për Reforma dokumentet dhe materialet e nevojshme për punën e Komitetit (raporte, analiza, propozime, prezantime, etj.);
 - b) Organizon dhe kryen përgatitjen e mbledhjeve të Komitetit dhe ndihmon në aktivitetet e tij;
 - c) Harton konkluzionet operative të mbledhjeve të Komiteti Monitorues të

- Instrumentit për Reforma dhe konsolidon raportet;
- d) Është përgjegjës për ruajtjen e dokumentacionit të Komitetit Monitorues të Instrumentit për Reforma;
 - e) Siguron publicitetin, sipas rastit, lidhur me punën e Komiteti Monitorues të Instrumentit për Reforma; dhe
 - f) Kryen detyra të tjera që lidhen me punën e Komiteti Monitorues të Instrumentit për Reforma, të cilat i caktohen nga Koordinatori Kombëtar i Instrumentit për Reforma.
- (3) Sekretariati është pika e kontaktit për Komitetin Monitorues të Instrumentit për Reforma dhe e gjithë korrespondenca që lidhet me aktivitetet e Komitetit i adresohet atij.

Neni 4

Mbledhjet e Komiteti Monitorues të Instrumentit për Reforma

- (1) Komiteti Monitorues i Instrumentit për Reforma mbledhet të paktën një herë në vit, pas dorëzimit të raportit vjetor. Në përputhje me nenin 25(1) të Marrëveshjes për Instrumentin, mbledhja e parë e Komitetit Monitorues të Instrumentit për Reforma mbahet jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes. Gjithashtu mund të ftohen mbledhje *ad hoc*, me iniciativë të Komisionit ose të Koordinatori Kombëtar të Instrumentit për Reforma.
- (2) Sekretariati i dërgon ftesat me shkrim së bashku me draftin e rendit të ditës të paktën 15 ditë pune para datës së mbledhjes së Komitetit Monitorues të Instrumentit për Reforma. Dokumentet mbështetëse dorëzohen së paku 10 ditë pune para mbledhjes. Informatat dhe të gjitha dokumentet dhe materialet e nevojshme mund të dërgohen përmes e-mailit.
- (3) Anëtarët e Komiteti Monitorues të Instrumentit për Reforma mund të paraqesin propozime me shkrim për ndryshime në rendin e ditës, drejtuar Sekretariatit, jo më vonë se 10 ditë pune para mbledhjes. Çfarëdo ndryshime në rendin e ditës pas këtij afati mund të bëhen vetëm me konsensus ndërmjet anëtarëve të Komitetit.
- (4) Komiteti Monitorues i Instrumentit për Reforma miraton rendin e ditës në fillim të çdo mbledhjeje.
- (5) Gjuha e punës e Komitetit Monitorues i Instrumentit për Reforma është gjuha angleze. Përkthimi simultan në dhe nga gjuhët zyrtare të Kosovës dhe përkthimi i dokumenteve ofrohen, sipas nevojës, nga Përfituesi.

Neni 5

Pjesëmarrja në mbledhjet e Komitetit Monitorues të Instrumentit për Reforma

- (1) Anëtarët e Komiteti Monitorues të Instrumentit për Reforma, të listuar në Shtojcën 1, marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e Komitetit.
- (2) Në rastet kur një anëtar nuk është në gjendje të marrë pjesë në një mbledhje të Komitetit, ai/ajo mund të zëvendësohet nga përfaqësuesi/ja i/e caktuar i/e tij/saj.
- (3) Përveç kësaj, në mbledhje mund të marrin pjesë edhe pjesëmarrës të tjerë të përcaktuar në

- Shtojcën 2.
- (4) Sekretariati, në bashkërendim me Komisionin, për zgjedh pjesëmarrësit e përmendur në Shtojcën 2, me qëllim të sigurimit të një përfaqësimi të përshtatshëm dhe të balancuar të ekspertizës përkatëse sektoriale.
 - (5) Lista e të ftuarve e përcaktuar në Shtojcën 1 dhe Shtojcën 2 dakordohet me Komisionin me kohë para çdo mbledhjeje.

Neni 6

Procesverbalet e mbledhjeve

- (1) Sekretariati harton konkluzionet operative si dhe procesverbalet e çdo mbledhjeje të Komitetit Monitorues të Instrumentit për Reforma.
- (2) Draft-konkluzionet operative u dorëzohen anëtarëve të Komitetit Monitorues të Instrumentit për Reforma për komente ose korrigjime brenda 10 ditësh pune pas mbledhjes. Drafti i procesverbalit, i cili përfshin rendin e ditës së mbledhjes dhe listën e pjesëmarrësve, u dorëzohet pjesëmarrësve brenda 20 ditëve të punës pas mbledhjes. Në të dyja rastet, komentet dhe korrigjimet me shkrim ofrohen brenda 10 ditëve të punës.
- (3) Konkluzionet operative të mbledhjes publikohen në ueb-faqen e Instrumentit për Reforma të paraqitur në Planin e Komunikimit dhe Promovimit të Përfituesit.
- (4) Konkluzionet operative përcillen në mënyrë të duhur dhe shqyrtohen në mbledhjet vijuese të Komitetit.

Neni 7

Kodi i sjelljes

- (1) Anëtarët dhe pjesëmarrësit e Komiteti Monitorues të Instrumentit për Reforma marrin pjesë në vendosjen, ruajtjen dhe zbatimin e standardeve të larta të sjelljes së Komiteti Monitorues të Instrumentit për Reforma dhe i respektojnë personalisht ato standarde, në mënyrë që të ruhet integriteti i Komitetit.
- (2) Anëtarët dhe pjesëmarrësit e Komiteti Monitorues të Instrumentit për Reforma nuk e përdorin anëtarësinë/pjesëmarrjen e tyre në Komitet për çfarëdo përfitim ose privilegj për vete ose për të tjerët.

Neni 8

Dispozitat përfundimtare

- (1) Kjo Rregullore e Punës e Komitetit u miratua nga anëtarët e tij në mbledhjen e parë të Komitetit Monitorues të Instrumentit për Reforma, të mbajtur më 17 qershor 2026, në Prishtinë.

Shtojca 1: Anëtarët e Komitetit Monitorues

1. Koordinatori Kombëtar i Instrumentit për Reforma;
2. Përfaqësuesit nga Bashkimi Evropian;
3. Përfaqësuesit e Zyrës së Kryeministrit, Ministrisë së Financave dhe/ose institucioneve të tjera të përfshira në zbatimin, koordinimin dhe kontrollin e Instrumentit për Reforma;
4. Koordinatori Kombëtar i Instrumentit për Asistencë të Paraanëtarësimit (NIPAC);
5. Institucioni Suprem i Auditimit.

Shtojca 2: Pjesëmarrësit e Komitetit Monitorues

Përfaqësues shtesë të palëve në vijim, por jo vetëm ata, mund të ftohen në baza *ad hoc* për të marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit Monitorues të RGF-së, duke mos u kufizuar në:

1. Ministri, agjenci, institucione të pavarura dhe organe të tjera relevante, përfshirë autoritetet lokale dhe/ose asociacionet e tyre;
2. Organizata të shoqërisë civile, partnerë socialë dhe asociacione të sektorit privat;
3. Institucione akademike dhe universitete;
4. Organizata ndërkombëtare dhe institucione financiare ndërkombëtare;
5. Shtetet Anëtare të BE-së;
6. Çfarëdo organ ose person tjetër që mund të konsiderohet relevant.